



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

DREJTORIA E FINANCË BUXHETIT DHE KONTABILITETIT

Nr. 10630 Prot

Fier, me 18.09.2025

PROJEKT VENDIM

Nr. 83 ,Datë 18 . 09 .2025

“Për një ndryshim në VKB nr. 138, datë 23.12.2024, ‘Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të aparatit të Bashkisë Fier, të funksioneve dhe të shërbimeve të Bashkisë Fier’.

Në mbështetje të Nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1.1, shkronja “b”, nenit 54 shkronja “ç”, nenit 55, pika 2, të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar); Ligjit nr.152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar); Nenit 113 të Ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”: Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); Nenit 9, shkronja “d” të Ligjit nr.35 /2023 , datë 24.3.2011 “Për Kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në Institucionet e Administratës Publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vëndi” ; Vendimit të Këshillit të Ministrave numër 503 datë 01.08.2024, “Për një ndryshim në VKM nr .328, datë 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve ,grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore,për efekt page,dhe caktimin e kufinjve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”; Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.422 datë 26.06.2024 “Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 326 datë 31.05.2023 "Për pagat e punonjëve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshëm në disa institucione të administratës publike"; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.425 datë 26.06.2024 "Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar" , Lidhja nr.3; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.139 datë 23.12.2024 “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm PBA (2025-2027) dhe miratimin e buxhetit të Bashkisë Fier për vitin 2025”, i ndryshuar, si dhe me ndryshimet e reja organizative në kuadër të ristrukturimit:

PROPOZOJMË:

1. Të miratohet niveli i pagës për drejtorët e përgjithshëm, sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela nr.1

Nr.	Emërtimi	Kategor ia	Klasa	Grupi I diplomës	Niveli i pagës
1	Drejtor i Përgjithshëm	I	I-3	1	130,000

Shtesa për vjetërsi në punë jepet në masën:

- 0.6% për çdo vit pune për 10 (dhjetë) vitet e para (1–10 vite), e llogaritur mbi pagën e pozicionit;
- 0.8% për çdo vit pune për 10 (dhjetë) vitet e dyta (11–20 vite), e llogaritur mbi pagën e pozicionit;
- 1% për çdo vit pune për 10 (dhjetë) vitet e treta (21–30 vite), e llogaritur mbi pagën e pozicionit.

Për efekt të llogaritjes së kësaj shtese, vite pune do të konsiderohen vjetërsia e përgjithshme në punë, e dokumentuar në librezën e punës së çdo punonjësi, me përjashtim të:

- viteve të sigurimit vullnetar,
- vetëpunësimit,
- shërbimit ushtarak të detyrueshëm,
- viteve të shkollimit në institucionet e arsimit të lartë, dhe
- periudhës së trajtimit me pagesë papunësie.

Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit, nëpërmjet VKM nr. 503, datë 1.8.2024, do të jepet, në masën si vijon:

Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit		
Grupi i diplomës	Niveli i kualifikimit sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK)	Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit (lek/muaj)
1	Niveli 7 i KSHK (Master i shkencave. Master i arteve. Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	14 000
2	Niveli 7 i KSHK-së (Master profesional. Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	12 000
3	Niveli 6 i KSHK-së (Bachelor. Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	10 000

2. Ky ndryshim do të reflektohet në Tabelën nr. 1, të miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 138, datë 23.12.2024, "Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të aparatit të Bashkisë Fier, të funksioneve dhe të shërbimeve të Bashkisë Fier."
3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi fillojnë nga data 1 tetor 2025 dhe përballohen nga buxheti i Bashkisë Fier për vitin 2025.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ekzekutivi i Bashkisë Fier.

Për Drejtorinë e Financës/Buxhetit dhe Kontabilitetit
Pranvera Cina

Drejtoria Juridike
Esmeralda Kapllanaj

Për Drejtorinë e Burimeve Njerëzore
Drejtori Rozeta Memo

KRYETARI
Armando Subashi

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
Zv/Kryetar
Suela Prifti

